



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Dorezimi Prilbena/Prodato Received/Delivery	19.04	2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHPK	1885/2021		1/4	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.121/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.121/2021 të datës 05.03.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë Rr.“Tirana”, Nr.57, Komuna e Prizrenit, kundër organit të punësimit/Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike “vlerësim i rezultateve të punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47 dhe 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 19.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.121/2021 e datës 05.03.2021 e parashtruar nga ankuesi**
- II. Anullohet** Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2020 i datës 11.02.2021 për ankuesin.
- III. Detyrohet** Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm për Operacione pranë Administratës Tatimore të Kosovës, që të bëjë rivlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 për ankuesin, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi Drejtor Rajonal në Administratën Tatimore të Kosovës, me datë 05.03.2021 ka parashtruar ankesë më numër protokollit 1003/2021 të regjistruar me numër A.nr.121/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020 të datës 08.02.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.03.2021 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Administratën Tatimore të Kosovës. Këshilli, me datë 19.03.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me numër protokolli 1003/2011 të datës 05.03.2011 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 08.02.2021; Listën e të hyrave tatimore dhe Rimbursimeve; Raportin statistikor për vizita sipas inspektorit; Raporti statistikor për kontrolla sipas inspektorit; Përmbledhje e shkurtër për punën e bërë në vitin 2021 në Drejtorinë Regjionale Gjakovë; Plani i Punës me Rishikim për Vitin 2020; Plani i Rishikuar i punës për vitin 2020; Plani i të hyrave sipas periudhave dhe llojeve të tatimeve për vitin 2020; Plani i të hyrave për vitin 2020 sipas Drejtorive rajonale dhe DTM; Plani 2020 dhe krahasimi i të hyrave pas transferimit të bizneseve nga Rajonet në DTM dhe anasjelltas dhe planin 2019; Plani 2020 i të hyrave sipas muajve për Drejtoritë Rajonale dhe DTM; Plani 2020 i të hyrave sipas llojeve të tatimeve për Drejtorisë Rajonale dhe DTM; Pasqyra e të hyrave sipas llojeve të tatimeve 2018-2019 dhe 2019-2020; Pasqyra e të hyrave të realizuara sipas Drejtorive Rajonale dhe DTM të grupuara për vitin 2018-2020 dhe 2019-2020; Plani i kontrolleve për vitin 2020 dhe realizimin 2019; Plani i kontrolleve për vitin 2020 sipas muajve për Drejtorisë Rajonale dhe DTM; Plani i vizitave dhe aktiviteteve për vitin 2020 dhe plani 2019; Plani i shpërndarjes së vizitave/kontrolleve për vitin 2020; Plani i mbledhjes së borxheve tatimore për vitin 2020 ne DTM dhe Rajone; Plani i mbledhjes së borxheve të kontributeve pensionale për vitin 2020-DTM dhe Rajone; Buxheti i planifikuar për vitin 2020; Projektet për vitin 2020; Akt Emërimit të datës 07.06.2018 të ankuesit; Formulari për planin individual të punës për periudhën janar-dhjetor 2019, janar-dhjetor 2020; E-maili i datës 24.01.2020, 28.01.2020, 20.09.2019, 03.02.2020, 07.02.2020, 30.01.2020, 20.02.2020, 28.02.2020, 19.05.2020, 21.05.2020, 01.06.2020, 08.06.2020, 11.06.2020, 17.06.2020, 15.07.2020, 03.08.2020, 04.08.2020, 04.08.2020, 11.08.2020, 12.08.2020; 13.08.2020, 27.08.2020, 28.08.2020, 22.09.2020, 02.10.2020, 14.10.2020, 21.01.2020, 29.10.2020, 09.11.2020, 10.11.2020, 11.11.2020, 20.11.2020, 19.11.2020, 03.12.2020, 21.12.2020 nga N.A; E-mailin e datës 07.02.2020, 02.12.2020 nga A.H; E-mailin e datës 19.02.2020 nga N.Sh; E-mailin e datës 20.11.2020 nga ankuesi dhe Përgjigjen në aneksë e datës 19.03.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e **bazuar, sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm i Operacioneve në Administratën Tatimore të Kosovës, në cilësinë e udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankuesit, me datë 08.02.2021 ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 për ankuesin në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të ATK-së në Gjakovë, duke e vlerësuar të njëjtin me notën e përgjithshme 2.59.

Ankuesi, i pakënaqur me këtë vlerësim, me datë 05.03.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se vlerësimi i rezultateve në punës është bërë në kundërshtim me nenin 7, nenin 8 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 dhe 1.2 dhe nenin 10 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve



në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike. Me tutje ankuesi pretendon se vlerësimin lidhur me objektivat e punës nuk mbështetet në fakte të bazuar sepse sipas planeve dhe raporteve vjetore për vitin 2020 drejtoria që ka udhëhequr i njëjti ka arritur rezultate të larta dhe përmbushje të planeve të punës. Propozon që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar duke ndryshuar vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2020 në pajtim me faktet e argumentuara lidhur me rezultatet e arritura në punë.

Kolegji për Shqyrtimin Ankesave lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, respektivisht nenin 3 ku është përcaktuar se: *1.Vlerësimi i rezultateve në punë – nënkupton një proces të përhershëm që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit i cili realizohet në pajtim me nenin 43 dhe 71 të Ligjit Nr. 06/L – 114 për Zyrtarët Publikë. Sjellja profesionale - nënkupton realizimin e punëve me cilësi dhe brenda afateve të përcaktuara, duke respektuar etikën në punë, duke treguar interesim për përmbushjen e detyrave të pozicionit dhe duke krijuar marrëdhënie të mira pune me kolegët. 1.3. Objektivat - janë përmbledhje të detyrave të punës të nëpunësit për periudhën një vjeçare të cilat rrjedhin nga objektivat e njësisë dhe përcaktohen bashkërisht me udhëheqësin e njësisë, nenin 7 ku përcaktohet se: Mbikëqyrësi, së paku një herë gjatë periudhës vlerësuese dhe/ose sa herë që vlerëson të nevojshme, zhvillon takime me nëpunësin për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të përcaktuara dhe sjelljet profesionale si dhe për dhënien e sugjerime për përmirësime të nevojshme si dhe nenin 8 paragrafi 2 ku përcaktohet se: Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin paraparak.*

Nga vlerësimi i shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur se udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ka dorëzuar ankuesit Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për vitin 2020 me datë 08.02.2021, dhe i njëjti nuk ka zhvilluar ndonjë takim me ankuesin për të diskutuar lidhur me realizimin e objektivave dhe rezultateve të arritura, andaj si rrjedhojë Kolegji konstaton se vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020 është bërë në kundërshtim me nenin 8 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 dhe paragrafi 2 dhe 4 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i bazuar.

Lidhur me përmbushjen e objektivëve të punës Kolegji ka shqyrtuar Raportin për të Hyra dhe Aktivitete në teren për periudhën kohore janar-nëntor 2020 dhe si rrjedhojë duke u bazuar në këtë dokument ka konstatuar se për Drejtorinë Rajonale të Gjakovës, për vitin 2020 kanë qenë të planifikuara 114 vizita ndërsa janë realizuar 329 vizita, që i bje 188.6% me shumë se vizitat e planifikuara. Lidhur me të hyrat, plani vjetor i planifikuar për Drejtorinë Rajonale të Gjakovës ka qenë 6.672,531 euro ndërsa janë realizuar 6.543,751 apo 102% e planit Vjetor. Ndërsa kontrolla tatimore për vitin 2020 kanë qenë të planifikuara 16 ndërsa janë realizuar 21, apo 131.3% të Planifikimit Vjetor.

Kolegji si fakt relevant me rastin e vendosjes mori parasysh edhe rrethanat e përcaktuara në Raportin Vjetor të Administratës Tatimore për Vitin 2020, ku shihet se situata e krijuar për shkak të pandemisë, ka ndikuar në uljen e numrit të aktiviteteve në teren, qoftë si rezultat e reduktimit të stafit apo si rezultat i mbylljes së bizneseve.



Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se vlerësimi është bërë në kundërshtim me metodologjinë e përcaktuar me legjislacionin në fuqi, Kolegji konstaton se pretendimi ankimor është i pa bazuar sepse metodologjia e vlerësimit të rezultatit përfundimtar është bërë në pajtim me nenin 10 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Andaj, duke marr parasysh të gjeturat si me lartë, bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi për aprovimin e ankesës, anulimin e formularit të vlerësimit të rezultateve të punës të vitit 2020 për ankuesin dhe kthimin e lëndës në rivlerësim të udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit.

Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm për Operacione pranë Administratës Tatimore të Kosovës, në cilësinë e udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankuesit, me rastin e rivlerësimit obligohet që të marr parasysh të gjeturat dhe të veproje sipas pikëpamjeve juridike të dhëna në këtë vendim.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.121/2021

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Kryetari i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm për Operacione në Administratën Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.